



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1380/1 Prot.

Tiranë, më 28.12.2023

V E N D I M

Nr.261 , Datë 28.12. 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën nr. 268 Regj, datë 18.12.2023, të paraqitur nga z.V.S kundër Shoqërisë Gjikutria sh.p.k, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas pretendimeve dhe shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, ankuesi deklaroi se, banon në qytetin e Korçës, i punësuar prej datës 23.08.2022, pranë firmës Gjikutria, me detyrën e magazinierit në kantierin Maliq, në projektin që kjo firmë po zbaton në ndërtimin e aksit rrugor Maliq-Lozhan-Strelces, detyrë të cilën e ka kryer deri në datën 31.01.2023. Pas kësaj date, pa i dhënë ndonjë arsye, është hequr nga kjo detyrë dhe është punësuar si n/magazinier dhe furnizues i mjeteve me naftë. Ankuesi deklaroi se, në punë ka qenë korrekt, por puna e tij nuk është vlerësuar nga ana e firmës. Ankuesi pretendon se, diskriminimi i tij konsiston në faktet e mëposhtme:

Ankuesi shpjegon se, më datë 09.08.2023, i ka ndodhur një aksident i rëndë me mjetin e firmës dhe në vendin e punës. Konkretisht, si çdo ditë është paraqitur në punë në orarin e caktuar dhe ka marrë detyrën nga drejtori i kantierit për furnizimin e mjeteve me naftë në gjithë gjatësinë e aksit të rrugës që do të ndërtohej. Jashtë çdo kushti teknik të transportit të karburantit (naftës) me mjetin kamion vinç, me targë AB 335 EM, në karrocërinë e të cilit ishte vendosur boti me 1000 litra naftë, me shoferin F.H, janë nisur për furnizimin e mjeteve rreth orës 13:30. Në vendin e quajtur malorja e Strelces, nga manovrimi që bëri shoferi, mjeteve iku mbrapsht me shpejtësi shumë të madhe të pakomandueshme, për shkak se edhe mjeteve ishte jashtë kushteve teknike (mungesë

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

frenash). Shoferi arriti të komandojë timonin majtas, duke shmangur humnerën, por duke u përplasur me masivin shkëmbor. Si pasojë, ankuesi shpjegon se është hapur dera e mjetit nga krahu i tij, duke e zënë ankuesin poshtë kamionit, ndërsa drejtuesi i mjetit dhe personi tjetër që ishte më ta në mjet, nuk pësuan gjë. Ankuesi ka mbetur poshtë makinës për rreth 1 orë e 30 minuta. Pas shumë përpjekjesh ankuesin e kanë nxjerrë nga “kthetrat” e kamionit.

Ankuesi shpjegon se, nga aksidenti ka marrë goditje shumë të rënda, fraktura në këmbën e majtë, frakturë në krahun e djathtë, goditje në kokë nga ana e majtë, me gjakderdhje. Më pas, ai ka marrë ndihmë më të specializuar në Spitalin e Korçës, ku mjekët, pasi panë gjendjen e ankuesit e nisën drejt Spitalit të Traumës. Pas ekzaminimeve, rezultoi se ankuesi kishte thyer këmbën e majtë dhe krahun e djathtë, si dhe qepjen e plagës që kishte marrë në kokë. Pas dy ditëve qëndrim në spital, ai i është nënshtuar një ndërhyrje kirurgjikale në këmbë dhe në krahë, operacion i cili zgjati 4 orë. Këmba dhe krahu janë mbërthyer me hekura dhe vidha, të cilat do të hiqen, sipas informacionit që i është dhënë nga mjeku, me një operacion të dytë. Ankuesi ka qëndruar 10 ditë në spital dhe më pas, rreth 1 muaj e gjysëm ka jetuar në shtëpi me qira në Tiranë, pasi nuk mund të lëvizte nga Tirana në Korçë, për të kryer vizitat tek doktori që e operoi.

Ankuesi pretendon se, diskriminimi i tij ka filluar në datën 09.08.2023, ditë kur ndodhi aksidenti e në vazhdim. Sipas ankuesit, është diskriminues indiferentizmi dhe mosinteresimi i përfaqësuesve të firmës për shëndetin e tij. Përfaqësuesit e firmes, nuk e kanë kontaktuar as fizikisht dhe as nuk e kanë marrë në telefon, për ta pyetur në lidhje me gjendjen dhe shëndetin e tij. Akoma më diskriminuese është sjellja e drejtuesit të parë të firmës, z. F. Gj, i cili, rreth 1 muaji e gjysëm nga aksidenti, pasi është kontaktuar nga ankuesi me anë të telefonit, i ka thënë se nuk kishte dijeni për ngjarjen. Sipas ankuesit, kjo përbën diskriminim që i bëhet punëtorit nga ana e punëdhënësit. Diskriminimi ndaj tij është rezultat i mos sigurimit të kushteve të punës dhe i mosveprimit të drejtuesve të lartë të firmës, dhe kjo ka sjellë si pasojë që ankuesi të privohet nga e drejta që të jetë si gjithë të tjerët. Tani, ai do të jetë një njeri i gjymtuar dhe i paaftë për punë. Si rezultat i aksidentit i shkurtohen disa vite jetë nga rrezatimi i dëmshëm (3 skanera, 1 në Spitalin e Korçës dhe 2 në Spitalin e Traumës në Tiranë, 1 operacion që zgjati 4 orë, 14 radiografi dhe 1 operacion radiografi të tjera për heqjen e hekurave etj.)

Ankuesi pretendon se është diskriminuar edhe ekonomikisht, sepse nuk është ndihmuar financiarisht si punonjës i firmës për të kaluar vështirësitë e momentit dhe ato në vazhdim, të cilat kanë ardhur për fajin e punëdhënësit.

Ankuesi shprehet se, është në gjendje ekonomike të vështirë dhe për pasojat që i janë shkaktuar, kërkon dëmshpërblimin që i takon sipas ligjit, sepse aksidenti është aksident në punë dhe jo aksident rrugor, sikurse kërkon t’a klasifikojë punëdhënësi. Ka dërguar disa shkresa në adresë të titullarit të firmës lidhur me dëmshpërblimin, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Ankuesi informon se, aktualisht po trajtohet me raporte mjekësore, që sipas mjekut do të zgjasin për 6 muaj.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri hetimin e rastit dhe vërtetimin e diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore dhe çdo shkak tjetër, si dhe marrjen e dëmshpërblimit për dëmtimin e shkaktuar.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të LMD, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesi V.S, është i datëlindjes 02.02.1962. Referuar akteve të vendosura në dispozicion nga ankuesi, rezulton se, ankuesi fillimisht është shtruar pranë Spitalit Rajonal Korçë, fakt ky që rezulton nga Kartela Klinike Nr.2886. Nga data 09.08.2023 deri në datën 18.09.2023, ankuesi ka qenë i shtruar pranë Shërbimit të Ortopedisë, në Spitalin e Universitar të Traumës, Tiranë. Për periudhën 10.08.2023 deri më datë 29.09.2023, ankuesi është trajtuar me raport për paaftësi në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi, lëshuar nga Spitali Universitar i Traumës. Më pas, duke filluar nga data 23.10.2023 deri më datë 22.12.2023, ankuesi është trajtuar me raport mjekësor për sëmundje që trajtohen ng Komisioni Mjekësor dhe mbulohen nga Sigurimet Shoqërore, lëshuar nga Poliklinika e Specialistëve Korçë. Diagnoza e përcaktuar sipas ICD 10, është *“Frakturë e kërcit përfshirë kyçin e këmbës.”*

Në datën 14.09.2023, ankuesi i është drejtuar Shoqërisë “GJIKURIA” sh.p.k, me një kërkesë për dëmshpërblim, si pasojë e aksidentit që ka pësuar në datën 09.08.2023. Sikurse ankuesi, deklaroi, ai nuk ka marrë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë nga ana e shoqërisë.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se është diskriminuar nga Shoqëria “Gjikuria” sh.p.k, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të ndrejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të moshës, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon

zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese. Ankuesi nuk parashton fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se sjellja e Shoqërisë Gjigjuria sh.p.k, bazohet apo ka si shkak, gjendjen shëndetësore, të cilën ankuesi e ka pretenduar si shkak diskriminues. Ankuesi ka parashtuar pretendimin se, punëdhënësi/ Shoqëria Gjigjuria sh.p.k, duhet të gjendet përgjegjës për ta dëmshpërblyer për shkak të aksidentit të ndodhur në datën 09.08.2023, si pasojë e të cilit ankuesi pretendon se ka pësuar dëme të rëndë në shëndetin e tij dhe ka identifikuar në formularin e ankesës si shkakun e pretenduar të diskriminimit “*gjendjen shëndetësore*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Sipas ankuesit, pretendimi për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*” konsiston në faktin që punëdhënësi/ Shoqëria Gjigjuria shpk, nuk ka marrë përsipër përgjegjësinë si punëmarrës për t’a dëmshpërblyer për dëmin e pësuar si pasojë e aksidentit të ndodhur në datën 09.08.2023, që sipas ankuesit, klasifikohet si aksident në punë dhe ka ndodhur për fajin e punëdhënësit/Shoqërisë Gjigjuria shpk. Si pasojë e këtij aksidenti, ankuesi pretendon se ka pësuar dëme të rënda dhe të parikuperueshme në shëndetin e tij dhe kjo ka ndodhur për shkak të mos sigurimit të kushteve të punës nga ana e punëdhënësit/Shoqërisë Gjigjuria sh.p.k.

Në thelb, kërkimi i ankuesit konsiston në, përcaktimin e përgjegjësisë së punëdhënësit Shoqërisë Gjigjuria sh.p.k, për aksidentin e ndodhur në datën 09.08.2023, aksident që sipas ankuesit ka ndodhur për shkak të fajësisë së punëdhënësit dhe si pasojë ai ka pësuar dëmtime të rënda dhe të parikuperueshme në shëndetin e tij. Pikërisht për shkak të kësaj ngjarje, që ankuesi pretendon se përbën aksident në punë, të ndodhur me faj të punëdhënësit, ai kërkon që të dëmshpërblehet nga ana e punëdhënësit/ Shoqërisë Gjigjuria sh.p.k, subjekt kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin nga ana e Shoqërisë Gjigjuria sh.p.k, për të trajtuar ndryshe rastin e tij, për shkak të gjendjes shëndetësore, të pretenduar si shkak diskriminues nga ankuesi.

Pasi shqyrtoi pretendimet dhe dokumentacionin e depozituar nga ankuesi Komisioneri vlerëson se, pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përgjegjësinë e punëdhënësit ndaj punëmarrësit, në rastet e aksidentit në punë.

Kodi i Punës në nenin 39 *“Përgjegjësia e punëdhënësit”*, pika 2, përcakton: *“2. Punëdhënësi, duhet të paguajë diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore, kur aksidenti ose sëmundja profesionale është pasojë e fajësisë së rëndë të punëdhënësit.”*

Në mënyrë të posaçme çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë, rregullohen bazuar në ligjin nr.10 237, datë 18.2.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, të ndryshuar dhe aktet përkatëse nënligjore të miratuara në këtë fushë. Në Kreun V, të ligjit të sipërcituar, rregullohet mënyra e njoftimit, hetimit administrativ, regjistrimit dhe raportimit të ngjarjeve dhe aksidenteve në punë.

Bazuar në në ligjin nr.10 237, datë 18.2.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”*, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 9634, datë 30.10.2006 *“Për inspektimin në punë dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”*, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore është struktura administrative dhe institucioni përgjegjës, i cili ka kompetencën për monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit të punës, përfshirë dhe çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, institucion të cilit ankuesi mund t’i adresojë problematikën e tij.

Për sa i përket kërimit të ankuesit për marrjen e dëmshpërblimit për dëmin që i është shkaktuar si pasojë e aksidentit të datës 09.08.2023, Komisioneri vlerëson se, një kërkim i tillë mund t’i drejtohet vetëm Gjykatës, si i vetmi autoritet që mund të marrë në shqyrtim një pretendim të kësaj natyre.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, nuk hyn në kompetencën e këtij institucioni, shqyrtimi i pretendimeve që ankuesi ka ngritur kundër punëdhënësit Shoqërisë Gjykatës sh.p.k lidhur me marrjen e dëmshpërblimit për shkak të aksidentit në punë të datës 09.08.2023, për sa kohë që ato nuk mund të konsiderohen pretendime për diskriminim, sipas parashikimeve të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes *“për çdo shkak tjetër”*. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi *“çdo shkak tjetër”* përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit *“çdo shkak tjetër”* mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar *“shkakun”* i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit *“çdo shkak tjetër”*. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohej nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk përbën një pretendim për diskriminim, sipas parashikimeve të LMD-së, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e LMD. Bazuar në nenin 32/1/a, të LMD, Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë vetëm ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, gjithë sa më sipër dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr. 268 datë 18.12.2023, e paraqitur nga ankuesi V.S kundër Shoqërisë Gjokuria shp.k, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon ankuesit, qw për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas³, ose Shërbimit Ligjor Falas⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.268, datë 18.12.2023, të paraqitur nga ankuesi V.S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shëndetësore, çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim

³ Me adresë: Rruga "Jordan Misja" Godina nr. 3, Tiranë. Numri i gjelbër: 0800 1010. Për më shumë informacion: <https://ndihmajuridike.gov.al/>.

⁴ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Tel: 0422 53113.

Lloji i vendimit: Mospranim